



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - HANI I ELEZIT
MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT



Nr: 02/ 2328 /2025
Datë: 07.04.2025

Në mbështetje të nenit 22 të Rregullores Nr.01/8214/2024 të datës 04.10.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe Rregullores MF me Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Komuna e Hanit të Elezit paraqet:

THIRRJE PUBLIKE

Për aplikimin e subvencionimit të OJQ-ve që ofrojnë në fushën e Kulturës, Sportit dhe OJQ-ve tjera, në vlerë totale prej 26,000.00 €

KULTURË (subvencione totale në vlerë prej 5,000.00 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha shoqëritë kulturore – artistike (jo fitimprurëse), të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit – Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilat janë të dëshmuara për organizimin e aktiviteteve kulturore, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2025 në politikat programore të Sektorit për Kulturë.

RINI DHE SPORT (subvencione totale në vlerë prej 18,000.00 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha klubet sportive të cilat janë të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit – Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të cilat janë të dëshmuara për promovimin, zhvillimin dhe masovizimin e sportit, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e aktiviteteve (garave) të tyre për vitin 2025, në politikat programore të Sektorit për Sport.

OJQ TJERA (subvencione totale në vlerë prej 3,000.00 €)

OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre të cilat duhet të kenë për objekt zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, respektivisht kujdesit, evokimit dhe këshillimit të personave – kategorive të ndryshme.

Kërkesa për aplikim për të gjithë sektorët Kulturë, Rini, Sport dhe OJQ-të e tjera duhet të përmbajné:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
- Projekt Porpozimin bashkë me koston totale;
- Aplikacioni (merret te Qendra për shërbim të qytetarëve);
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- Dëshmi mbi pagesën e Tatimit në pronë;
- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e vendbanimit (për persona fizik);
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Federatës Përkatëse (vetëm për klubet);
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit/es/që përfaqëson organizatën;
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare e aplikuesit/es;
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- Raporti narrativ i vitit 2024 ose periudhës së më hershme kur aplikuesi ka qenë përfituesi/ja e subvencionimit;
- Gjatë aplikimit të subvencionimit 2025, aplikuesi/ja/OJQ-të janë të obliguar të dorëzojnë faturat origjinale të shpenzimeve.

Afati për aplikim është nga data 07.04.2025 deri 24.04.2025.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Hanit të Elezit, Qendra për Shërbim të Qytetarëve.

Vërejtje:

- Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;
- Konkuruesit/et të cilët/at nuk kanë përmyllur avancet e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;
- Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen;
- Preferohet që të gjitha dokumentacionet të plotësohen në mënyrë elektronike.

